



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:161548

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06799078

KA.nr.727/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit D.P B.I., me seli në fshatin Bellacerkë, Komuna e Rahovecit, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Shqipron Zymeri, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit me nr. me numër të prot. 4189 të datës 15.06.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor publik me datë 22.01.2025, me pjesëmarrje të përfaqësuesit me autorizim të paditësit, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 29.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësit D.P B.I., me seli në fshatin Bellacerkë, Komuna e Rahovecit kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me çka ka kërkuar të anulohet vendimi me numër të prot. 4189 të datës 15.06.2021.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 22.07.2021, në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi D.P B.I., me seli në fshatin Bellacerkë, Komuna e Rahovecit, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.1642/2021, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, (tutje referuar MBPZHR-AZHB) me seli në Prishtinë, me propozim që Gjykata të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të anulohet vendimi me nr. me numër të prot. 4189 të datës 15.06.2021, i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave pran të paditurës .
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 727/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik më datë 23.10.2024, konform nenit 41 të LKA-së, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit Avokat Shqipron Zymeri, sipas autorizimit të datës 14.08.2023, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur nga avokatura shtetërore, të ftuar në mënyrë të rregullt, të cilët mungesën e kanë arsyetuar përmes parashtrësës deklarim për seancë, e datës 16.01.2025.

Pretendimet e palës paditëse

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se përmes vendimit të kundërshtuar atij i është refuzuar ankesa për kërkesën e grantit nga Masa 101.2-Serra. Vendimi në fjalë ka ardhur në kundërshtim me provat e administruara me rastin e parashtrimit të kërkesës, pasi që paditësi nuk ka pasur mundësi që të aplikoj me kohë, sepse ka qenë në vet izolim, për shkak të pandemisë Covid 19, dhe nga kjo arsye ka ardhur deri te vonesa.
5. Ka theksuar se paditësi në rastin konkret i kishte plotësuar të gjitha kriteret për të fituar subvencionim dhe për këtë arsye edhe vet e paditura e kishte vendosur në listat e përfituesve të subvencioneve-grantit dhe i njëjti me qëllim që të zhvilloj biznesin e tij ishte munduar që t'i plotësoj të gjitha kriteret të cilat i kishte plotësuar, ndërsa dorëzimi i pagesave edhe pse ishin të kryera i njëjti nuk kishte mundur t'i dorëzoj dhe i ishte vonuar për dy ditë në zyrën regjional në Prizren për arsyet e Covid/19. Gjykatës i ka dorëzuar

provat dhe i ka propozuar që të aprovohet kërkesëpapia e paditësit dhe të anulohet vendimi me nr. të prot. 4189 i datës 15.06.2021 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave pran të paditurës.

Kundërshtimet e palës së paditur

6. Përfaqësuesja e të paditurës në pretendimet e dhëna përmes përgjigjes në padi të dorëzuar sipas parashtrësës së datës 18.11.2024, ka deklaruar se vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, ndërsa nuk qëndron pretendimi i palës paditëse se vendimi është marr me shkelje ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpapia e paditësit.

Provat e administruara

7. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar me numër 4189 i datës 15.06.2021 nga AZHB Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, Raportet mjekësore të datës 01.03.2021, 16.09.2020, 30.06.2020, raport i datës 20.09.2020. Nga provat e administruara gjykata vërtetoj këtë gjendje faktike.
8. Nga Vendimi i kundërshtuar me numër 4189 i datës 15.06.2021 nga AZHB Komisioni për shqyrtimin e ankesave, përmes këtij vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e “D.P” B.I, duke e lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë të datës 21.10.2020 me nr. të prot. 07/4/5478, Ref.AZHB-07/04/03/2157/2019, me arsyetim se Fermeri “D.P” B.I, ka aplikuar dhe është përfitues nga AZHB-ja për projektin ‘Ndërtimi i serrës moderne për prodhimin e perimeve me sipërfaqe 32” nga masa 101-investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, nën masa 101.2-Serra. Më datë 15.07.2020 i njëjti ka bërë kërkesë për zgjatje të afatit të implementimit të projektit, e cila i është aprovuar, për çka edhe ka lidhur Aneks Kontratën me nr. 11/2020 për zgjatje të afatit edhe për 30 ditë. Pas kalimit të afatit për paraqitjen e kërkesës për pagesë, fermeri ka bërë kërkesë për rivendosje të afatit, të cilës i ka bashkangjitur dokumentet nga kontrollet mjekësore dhe rekomandimet e mjekut, por

kërkesa është refuzuar nga Komisioni për shkak të mos respektimit të afatit për pagesë, me arsyetim se mungojnë provave të qëndrueshme. Më datë 28.09.2020 ka paraqitur kërkesën për pagesë, e cila është bërë jashtë afatit ligjor dhe kontraktual. Komisioni ka shqyrtuar provat si: Kërkesa për rivendosjen e afatit për pagesë me nr. 07/4/3748 e datë 15.07.2020, raportin mjekësore të datës 15.07.2020, Qendra e Mjekësisë Familjare-Rahovec, Raport i Emergjencës Spitali Isa Grezda Gjakovë i datës 20.02.2020, Vendimi i Komisionit i datës 03.09.2020, Kërkesa për pagesë e datës 28.09.2020, Vendimi për Refuzimin e përkrahjes së projekteve për bujqësi dhe zhvillim rural të datë 21.10.2020, e protokolluar me nr. 07/4/5478 e datës 26.10.2020, Raporti i Laboratorit Biokimik Hematologjik “Shëndeti” Gjakovë, i datës 15.09.2020, Udhëzimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Rahovec për testim për Covid e datës 20.09.2020, Raporti nga Konsulta e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Rahovec e datës 16.09.2020, Raporti nga Konsulta e QMF-së Rahovec e datës 30.06.2020, Pasqyrë e transaksioneve bankare.

9. Komisioni gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit nuk qëndrojnë ngase, dokumentet mjekësore të cilat janë paraqitur si prova nuk janë të besueshme pasi që mbajnë numra serik të përifertra 4925 dhe 4946 nga data 16.09.2020 si dhe nuk i përkrahin pretendimet e fermerit, pasi që sipas raportit të mjekut të datës 30.06.2020 duhej të hynte në izolim pas konstatimit të mjekut se ka pasur simptoma të Covid 19. Nuk ka sjellë dëshmi se është testuar nga IKSHP-ja, as se i njëjti ka kryer testin PCR, por sipas raporteve shihet se ka kryer testin serologjik më datë 15.09.2020, i cili tregon e ka kaluar covid-19, ndërkaq me raportin tjetër i cili nuk dihet se është i datës 10 apo 20 2020, dyshohet për simptoma dhe rekomandohet nga mjeku të testohet për Covid 19. Sipas kontratës dhe aneks kontratës Fermeri është dashur që kërkesën për pagesë, marr për bazë vendimin e Ministrisë për shtyerjen e afatit të datës 06.03.2020, ka pasur mundësi që deri në Korrik të vitit 2020 të përgatisë kërkesën për pagesë, të cilën nuk ka arritur ta bëjë deri më datë 28.09.2020, prandaj nuk qëndron pretendimi i ankuesit se është vonuar 4 deri në 5 ditë për paraqitjen e kërkesës për pagesë. Komisioni në bazë të nenit 33 dhe 34 të UA MBPZHR 16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2019, nenit 4 të kontratës nr. 134/2019 dhe Aneks kontratës Nr. 134/2019, vendimeve të Ministrisë të datave 16.03.2020 dhe 15.06.2020, konstatoi se kërkesa është bërë jashtë afateve për pagesë.

10. Nga Raportet mjekësore: raporti i datës 30.06.2020, është konstatuar se ka simptoma të Covid 19 dhe se duhet të vetë izohet, nga raporti mjekësor i datës 16.09.2020, është konstatuar nga Specialisti i Mjekësisë Familjare në Gjakovë se personi në fjalë ka qenë në vetë izolim prej datës 01.07.2020 deri më datë 14.07.2020, nga Raporti Mjekësor i datës 20.09.2020 është rekomanduar që të bëjë testin Covid 19.

Baza Ligjore

11. Udhëzim Administrativ (Mbpzhr) - Nr.16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Neni 34 përcakton kërkesën për pagesë par. 1. Parashih se “Përfituesit që kanë përfunduar investimin sipas kontratës, e dorëzojnë kërkesën për pagesë në Zyrat Regjionale të AZHB-së, pika 13 përcakton se “pagesa duhet të bëhet në afat prej 20 ditësh nga dita e Vendimit për pagesë”.
12. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 79 përcakton rivendosjen në afat, ku par.1. parasheh se “Përpos kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në rastet kur për arsye të justifikuara e jo për faj të vet, një palë që është penguar për respektimin e një afati procedural, mund të kërkojë rivendosjen e afatit të humbur, par. 2 parasheh se “Rivendosja në afat, mund të kërkojë për humbjen e afatit për parashtrimin e kërkesës fillestare, mjetit juridik administrativ, atij për kryerjen e një veprimit tjetër procedural gjatë procedurës administrative, si dhe për çdo afat tjetër që ecën kundrejt palës”, par. 3 parasheh se “Kërkesa për rivendosjen në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, por jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i afatit të humbur, par. 4 parasheh se “Në rastin kur pala është penguar nga një forcë madhore, kërkesa për rivendosje në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, pavarësisht nga koha që ka kaluar nga skadimi i afatit të humbur”, par. 5 parasheh se “Veprimi procedural të cilin pala nuk ka arritur ta përmbushë, duhet të kryhet brenda afatit të parashikuar për të kërkuar rivendosjen në afat, sipas këtij neni”, Neni 80 Vendimi dhe pasojat e rivendosjes në afat 1. Shqyrtimi i kërkesës për rivendosjen në afat është në kompetencën e organit publik kompetent për çështjen administrative në fjalë. Ky i fundit vendos brenda dhjetë (10) ditësh nga parashtrimi i kërkesës. 2, “Nëse miratohet rivendosja në afat, veprimet administrative që janë kryer si pasojë e tejkalimit të afatit anulohen, sipas ligjit”.

Vlerësimi i gjykatës

13. Gjykata në rigjykim vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
14. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 34 par. 16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) nr. 16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për Vitin 2019 (më tutje referuar si UA nr.16/2019), i cili përcakton se: *“Kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, pala ka të drejtë që të ushtroj padi për konflikt administrativ në afat prej 30 ditësh, në gjykatën kompetente”* dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*
15. Gjykata i vlerësoi si të pa bazuara ne ligj pretendimet e paditësit dhe ne kundërshtim me provat e administruara. Nuk është kontestuese fakti se paditësi kishte përfituar projektin nga masa 101, nën masa 101.2 –Serra, sipas thirrjes për aplikim të shpallur nga e paditura MBPZHR-AZHB, pasi që për këtë projekt kanë qenë të nënshkruara nga të dyja palët Kontrata me numër 134/2019 për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural e datës 07.11.2019, duke pësuar pastaj me Aneks Kontratën e datës 31.01.2020.
16. Gjykata vlerëson se nga Raportet mjekësore: raporti i datës 30.06.2020, është konstatuar se ka simptoma të Covid 19 dhe se duhet të vetë izohet dhe ta beje testin për covid19. Edhe pse i njëjti nuk ka bere testin sipas rekomandimit te mjekut. Nga raporti mjekësor i datës 16.09.2020, është konstatuar se personi në fjalë ka qenë në vetë izolim prej datës 01.07.2020 deri më datë 14.07.2020, nga Raporti Mjekësor i datës 20.09.2020 është rekomanduar që të bëjë testin Covid 19. Paditësi më datë 15.07.2020, pas përfundimit te periudhës se izolimit kishte parashtruar kërkesë për rivendosje të afatit për pagesë më numër të protokollit 07/4/3748.

17. Sipas Neni 79 p. 3 të LPPA-së të cituar më larte, “Kërkesa për rivendosjen në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, por jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i afatit të humbur, ndërsa sipas par. 5 “Veprimi procedural të cilin pala nuk ka arritur ta përmbushë, duhet të kryhet brenda afatit të parashikuar për të kërkuar rivendosjen në afat. Gjykata e vlerëson te drejte konstatimin e Komisionit se paditës nuk ka sjellë dëshmi se është testuar nga IKSHP-ja, as se i njëjti ka kryer testin PCR, por sipas raporteve shihet se ka kryer testin serologjik më datë 15.09.2020, i cili tregon e ka kaluar covid-19, ndërkaq me raportin e datës 20/09/2020, dyshohet për simptoma dhe rekomandohet nga mjeku të testohet për Covid 19. I njëjti serish nuk ka sjell testin sipas rekomandimit të mjekut. Ndërsa, më datë 28.09.2020 ka paraqitur kërkesën për pagesë, e cila është bërë jashtë afatit ligjor. Sepse nga periudha e përfundimit të izolimit rezultojn te jete me date 14.07.2020, kërkesa për rivendosje është bere brenda afatit me date 15.07.2020 dhe po me këtë kërkesë apo brenda afatit prej 15 diteve (deri me date 01.08.2020) është dashur ta dorëzoj kërkesën për pagesë, siç përcaktohet në Nenit 79. p 5 *Veprimi procedural të cilin pala nuk ka arritur ta përmbushë, duhet të kryhet brenda afatit të parashikuar për të kërkuar rivendosjen në afat.*
18. Sa i përket Raportit Mjekësor të datës 01.03.2021 ku konstatohet se pacienti pas testimit për Covid19 për herë të dytë me datë 24.01.2021 rezultojn me covid gjykata konstaton se raporti i hartuar nga doktori E. K i datës 01.03.2021 nuk përmban nënshkrimin dhe faksimilen e mjekut. Prandaj gjykata i vlerëson si të bazuara vlerësimet e Komisionit se prova e paraqitur nga paditës nuk është e besueshme.
19. Gjykata konstaton se e paditura ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe ka vepruar në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 79 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton Rivendosjen në afat, ku par.1. parasheh se “Përpos kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në rastet kur për arsye të justifikuar e jo për faj të vet, një palë që është penguar për respektimin e një afati procedural, mund të kërkojë rivendosjen e afatit të humbur, par. 2 parasheh se “Rivendosja në afat, mund të kërkohe për humbjen e afatit për parashtrimin e kërkesës fillestare, mjetit juridik administrativ, atij për kryerjen e një veprimit tjetër procedural gjatë procedurës administrative, si dhe për çdo afat tjetër që ecën kundrejt palës”, par. 3 parasheh se “Kërkesa për rivendosjen

në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, por jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i afatit të humbur, par. 4 parasheh se “Në rastin kur pala është penguar nga një forcë madhore, kërkesa për rivendosje në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, pavarësisht nga koha që ka kaluar nga skadimi i afatit të humbur”, par. 5 parasheh se “Veprimi procedural të cilin pala nuk ka arritur ta përmbushë, duhet të kryhet brenda afatit të parashikuar për të kërkuar rivendosjen në afat, sipas këtij neni”.

1. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.727/22, datë 29.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.